

Botim i Qendrës Përpjekja

Përfijëqja do të botohet katër herë në vit

Ky numër u përgatit nga:

Fatos Lubonja
Artan Puto
Eldon GjikaAbonimet 2003
- për Shqipërinë
- për jashtë shtetit:
600 lekë për numër
10 Euro për Evropën
10 USD për SHBA.

Revista do të shiet në libraritë kryesore.

Botimi i këtij numri u bë i mundur
në sajë të ndihmës bujare të
PRESS NOW

Për abonimet dëjtohur:

Artan Puto
Rr.Lidhja e Puzerentit Pll3, ap. 5
TiranëE-mail: putoa@albnat.net
Tel/fax 355-42-24220
Tel 355-692209126Përpjekja falenderon Ministrinë
e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe
Sporteve për dhënien e çmimit
"Revista kulturore më e mire e
viti 2005" që do të ndihmojë të
botohen edhe disa numra të
revistës.Korespondenca të dërgohet në adresat e sipër-
përmendura. Honorarët për shkrimet e botuara do të
pëqihen pas daljes së numrit. *Duke patur parasysh
vështirësitë që has revista do të preferonim kontributin
falas.* Dorëshkrimet e papërdonura nuk kthehen.

Ese

- 2 Dimensioni panal në
intelektualizmin post-
komunist shqiptar nga
Fabian Kati

96

e pasluftës nga *Anna Di Lello,*
Stephanie Schwander-Sievers

Kritikë letrare

- 13 Fryma romantike dhe
nacionaliste në debatin për
"identitetin shqiptar" nga
Artan Puto

34

Evropa e ngurtë e Kadarese
nga *Enis Sulstarova*

103

Ndërgjegje historike

52

Oksidentalizimi i së
shkuarës dhe orientalizimi i
së tashmes: identiteti
'evropian' i shqiptarëve sipas
shkrimtarit Ismail Kadare e
presidentit Aleksander
Mojisiu nga *Adrian Brisku*

134

Shënime mbi një libër të
harruar nga *Rigels Halili*

70

'Esenca' jonë identitare dhe
kamhalizmi kulturor nga
Fatos Lubonja

147

Kuffri politik, kuffri etnik dhe
shtet-komb. Shembulli i
krahinës pranë kufirit
shqiptaro-grek gjatë periudhës
mids dy luftave
nga *Nahalie Clayer*

71

Komandant i legjendar:
ndërtimi i një master-
narracioni shqiptar në Kosovën

PERPJEKJA

E përtremuajshme kulturore

PERPJEKJA

E përtremuajshme kulturore

Botim i Qendrës Përpjekja

**KOMANDANTI LEGJENDAR: NDËRTIMI I NËJË MASTER-NARRACIONI
SHQIPTAR NË KOSOVËN E PASLUFITËS***

Nga Anna Di Lellio ** dhe Stephanie Schwandner-Sievers ***

ABSTRAKT. Konstruktimi në vazhdim pas lufte i dëshmorëve, kujtesës dhe kombit shqiptar në Kosovë ka prodhuar trope ikonike të rezistencës militante të unitetit dhe të pavarësisë kombëtare. Ky vlerësim kritik interpretues, i mbështetur në vite të tërë të angazhimit etnografik dhe politik të autorëve me shqiptarët e Kosovës së paslufitës, fokusohet në krijimin e një master-narrative të përqendruar në “Tijiminin sublim” të udhëheqësit kryengritës të UÇK-së, Adem Jashari, i njohur si “Komandanti Legjendar”. Ai po ashtu mëton të gjurmtojë zërat disonantë me këtë master narrative, duke i sprovuar kontestimet ndasive rurale-urbane, politike dhe gjinore në shoqërinë kosovare-shqiptare. Ai konkludon se pikepamja e ngushtë ndërkombëtare në kupim gofite të “vikimes”, apo “shkakarëve”, ka kontribuar në konsolidimin e kësaj narrative të fuqishme, krenaritit të veprimit shqiptar në rezistencë militante dhe në mbylljen e debatit publik brenda shoqërisë shqiptare.

Ky artikull fokusohet në ndërtimin e një master-narracioni gjithëshqiptar në Kosovën e paslufitës, një vijë rrëfyese për një vend të pavarur që mbart po ashtu një identitet kolektiv nacional. Kosova nuk është shtet i pavarur dhe nuk është më as pjesë e Serbisë dhe Malit të Zi, por mbahet në kujdestarinë e Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Statusi i saj politik është qëshije e kontestuar, negocimi i së cilës është e ndikuar nga kupime historike dhe identifikime nacionale konkurruese. Këtu kemi

* Ky artikull u bëua së pari në anglisht në revistën *Nations and Nationalism*, Vëll. 12, Nr. 3, Korrik 2006, fq. 513-529. Autorët i janë mirënjohëse Avni Spahiu, drejtor i Radio Kosova, për përkrahimin e artikullit në shqip, si edhe Enis Sulstarovës dhe Artan Puto për punën e tyre të kujdesshme në redaktimin e tekstit. Të drejtat në gjuhën shqipe për këtë artikull i janë dhuruar me mirësjellje nga Blackwell Publishers revistës *Përpjekja*. Falenderimet tona janë për shqiptarët që mbështeten këtë projekt: Për komentet kritike ndaj varianteve të ndëparshme të artikullit falenderojmë Daniela Gobetti, Daniel Levy, Garry Marvin, Guenther Roth, Ruth Seifert and Allan Silver. Fotografitë (figurat 1 dhe 2) janë marrë prej autoreve.

** Studjuese e pavarur, Nju Jork

*** Shtetlloja e Studimeve Sllavonike dhe e Europës Lindore, University College Londër

ofruar një gasje kritike mbi ngjritjen e një narrative homogjenizuese në shoqërinë shqiptare, një temë kjo së cilës nuk i është kushtuar vëmendje akademike ndërkombëtare deri më tani. Në jemi përqendruar në një ngjarje të vetme simbolike, masakrat e familjes kryengritëse të Jasharëve, të vrarë në fshatin Prekaz në mars të vitit 1998, në luftë me trupat serbe. Kjo nuk ishte masakra e vetme apo më e madhe gjatë konfliktit të fundit, por ky është vendi ku ndërthuren shumë rrethime. Kjo nuk është një ngjarje e vetme ngaqë rrethimi i njërzve të përfshinë, të lindur dhe të mirur në rajonin rural kryengritës të Drenicës, nuk fillon aty. As vetëkja dhe shkatërimi i shtëpive të tyre nuk është mbarimi i rrethimit; menjëherë pas asaj ngjarjeje lufta u përhap dhe u intensifikua; filloi gjithashtu një fushatë në media, letërsi, arte, historiografi dhe në ceremonitë publike për të prodhuar domethenie dhe kujtime të masakrës si simbol i çlirimit kombëtar shqiptar. Sot, ky simbolizëm ka mbështetje të fortë në imagjinatën shqiptare në komunitetet në Kosovë, më gjerë në rajonin e Ballkanit,² dhe në mesin e diasporës. Adem Jashari, i identifikuar si udhëheqës ushtarak i familjes dhe i rezistencës së armatosur të shqiptarëve, është bërë i njohur si *komandant legjendar*.³ Figura mitike që lihb brezat e kaluar dhe të ardhshëm me kombën. Vendi ku ai u vra me familjen e tij është cak popullor i një turizmi politik që ka marrë karakter të pelegrinazhit.⁴ Në propozojmë se master-narracioni i një Kosove shqiptare të përqendruar në Prekaz dhe mbi Adem Jasharin magjeps identitetin shqiptar si një traditë mitike e rezistencës së armatosur kundër shtypësve të huaj, sidomos kundër serbëve pas aneksimit të vitit 1912 të provincës osmane të Kosovës. Kjo master-narrativë është ndërtuar nga 'sipërmarës të kujtesës' (angl.: 'memory entrepreneurs'. Jelin 2003: 34), të cilët imagjinojnë dhe vendosin konkretisht në shoqërinë vendore, tradicionaliste dhe rurale. Përmes këij procesi, të ndërtuar mbi ndërveprimin e fuqishëm të zisë private me atë publike, ata sjellin elemente me peshe të politikës së identitetit dhe u japin domethenie traumave kolektive të përvojës të luftës së fundit. Master-narracioni i ndërtuar kështu rezonon kundrall grupeve të ndryshme, ngaqë rikujton një vetëkuptim të përbashkët si një komb i shtypur që kërkon çlirim politik dhe psikologjik. Kjo po ashtu nxiti kritikën, sidomos nën-narracione dhe kontestime që nuk përqafojnë aspektet mitike të luftës dhe rezistencës. Por, ajo nuk lë hapësirë për mospajtim publik, kurse homogjenizimi i dukshëm i identitetit kombëtar shqiptar që pason, përthën një pengesë ndaj pluralizmit dhe ekzistencës civile kombëtare. Në argumentojmë se për të kuptuar se si është ndërtuar ky master-narracion kosovar, pse është aq i fuqishëm dhe cilësi janë kufijtë e tij, duhen dëgjuar dhe diskutuar rrethimet

1 *Fjalori i Anglishtes i Oksfordit* dhe ai Webster e përkufizojnë masakrën si 'vrasje të padallim të qenave njerëzore' dhe si 'pësim masiv'.

2 Porrimi i shteteve-kombe nga rreth e Perandorisë Osmane i ndau provincat administrative të komnara me shumicë të popullsisë shqiptolëse: Kosova, Janina, Shkodra dhe Manastiri. Bashkësia kombëtare gjithshqiptare do të kishë përfshirë të gjithë pasardhësit e asaj popullsie dhe territorin e saj.

3 Temat lidhur me vendin e Jasharëve dhe të pelegrinazhit e kemi zhvilluar më në thellësi në një artikull tjetër (Di Lello and Schwandter-Sievers 2006).

dhe zërat e shumtë lidhur me masakrën e Prekazit.

Hulumtimi ynë jep ndihmesë për studimin e nacionalizmit nga 'një perspektivë ngjarjeje' (Brubaker 1996: 21). Në fokusohemi në dinamikën që ngjarja e masakrës së Prekazit ka gjeneruar brenda shoqërisë shqiptare të Kosovës dhe më larg, një 'fushë' të diferencuar, ku pozitat dhe qëndrimet politike konkurrojnë për hegjemoni (po aty: 60). Qasja jonë është ndërdisiplinore, mbështetur në një përdorim të gjerë të literaturës vendore, medias, arkivave të historisë gojore dhe të burimeve të komunikimit në internet. Në po ashtu kemi gjurmuar për zëra dhe rrethime individuale që nuk janë hasur në ndonjë forum publik apo që nuk janë ende interesante për mediat lokale, historiografinë, apo hulumtimin shoqëror dhe i kemi gjetur ato në qindra intervistas personale, bisada joformale dhe në observimet e pjesëmarrësve të bëra gjatë gjasthë hulumtimeve.⁴ Koha dedikuar punës në terren dhe ndërveprimi i vazhdueshëm me shoqërinë vendore na ka mundësuar të tejkalojmë heshtjen fillestare dhe herë-herë dyshimin e komunitetit dhe të pranoheshim në mesin e tyre me një lloj ngurrimi, por të gjenim edhe mikpritje nëpër shtëpi private. Kjo na ofroi një shans unik për të kuptuar marrëdhënien midis kujtesës, historisë dhe kombit, ashtu siç përjetohet dhe negociohet.

Gjatë hulumtimit të dinamikës së nacionalizmit të kujtesës, ne, po ashtu, kemi patur parasysh se asnjë studim i nacionalizmit nuk duhet t'ia pakësojë vlerën marrëdhënive midis identitetit kombëtar dhe shtetit. Gjatë viteve 1990, një identitet kombëtar shqiptar, duke shtruar kërkesa unike promesore ndaj provincës së atëherëshme jugosllave të Kosovës, u homogjenizua nga poshtë, por gjithashtu edhe nga lart: nga poshtë, përmes rezistencës popullore që mori formën e moshindjes civile dhe krijimin e një shoqërie paralele shqiptare kundrall shtetit serb, madje edhe kur celulat e nëndeshme kishin filluar të planifikonin një luftë gueritle; nga lart, për shkak të shtypjes së drejtpërdrejtë shtetërore si dhe të politikave të përcaktimit të grupeve emke dhe të drejtave e tyre. E drejta kushtetuese për autonomi nga Jugosllavia dhe identifikimi me përqendruar të Jasharët është i ndërtuar në kontekstin e protektoratit ndërkombëtar që qeveris Kosovën që nga viti 1999, së pari vetëm dhe nga viti 2002 bashkë me institucionet e përkohshme të vetëqeverisjes. Fuqia dhe drejtimi i politikës së identitetit fuqizohet nga një rregullim i veçantë institucional që aktualisht qeveris shqiptarët në Kosovë, ku mungesa e shtetësisë është gjithashtu një pengesë ndaj debatit të brendshëm:⁵ 'ne nuk mund të merremi lani me lirinë e shpërljes, së pari duhet të jemi të

4 Kemi intervistuar disa qindra njerëz të moshave, gjimve dhe statusit të ndryshëm shoqëror në Kosovë dhe në diasporë. Prej tyre, 100 janë intervista formale, që ndrysojnë nga komente të shkurtra në biseda më të gjata, shpesh të përsëritura gjatë viteve. Po ashtu, kemi bërë intervista të passtrukturuarra grupeve dhe familjare, si dhe hulumtime sistematike me fokusim grupor. Emogjrafia jonë përfshin edhe administratorët ndërkombëtarë.

5 Kur ndodh që të ketë ndonjë debat intelektual mbi identitetin kosovar, siç ka ndodhur shkurtimeisht në javoren 'Java' gjatë vitit 2001/2, ata fokusohen midis Kosovës dhe Shqipërisë, kurse kulti i Jasharit the kujtimet e luftës nuk vihen në dyshim.

pavarur', është koment i një mësuesi.

Shqipëtarët në Kosovë shqetësohen me vetëvendosjen dhe pavarësinë, një qëllim ky që ata besojnë se është një e drejtë në pajtueshmëri me kornizat ligjore dhe politike të shkolionizimit. Prania në vazhdim e një protektorati ndër-kombëtar mi-shëron mohimin e kësaj aspirate. Ajo përkthehet si një shtet surrogat që përbën shogërinë civile si një objekt të proektitimit, mësimit dhe rregullimit, por jo si një veprim i pavarur, me histori të vetën. Kjo gjë ka ngushtuar fokusimin e aktorëve vendorë të një bërtamë thelbësore e pavarësisë si shtetësi e fituar përmes luftës heroike kundër dominimit të huaj. Kjo ka mbajtur kritikën nën sipërfaqe dhe ka përforcuar forcën unifikuese të master-narracionit. Në fjalët e një gazetari të shquar vendor, 'ishin ndër-kombëtarët ata që shlyjnë shqipëtarët drejt folklorit'. Ndonëse nuk ka dëshmi se shqipëtarët janë të shurdhër ndaj vlerave të demokracisë dhe të drejtave të njeriut, kontrolli vendor mbi territorin dhe sigurinë, dmth. shtetësia e pavarur e Kosovës ka përparësi ndaj respektimit të larmisë, aq më pak ndaj pakicave etnike.

Komandanti legjendar

Ngjarjet që filluan më vonë e Prekazit dhe të komandantit legjendar Adem Jashari ndodhën gjatë tri ditëve, nga 5 deri më 7 mars 1998. Adem Jashari ishte në mesin e themeluesve të një organizate të vogël klandestine: Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, apo UÇK. Ky grup i armatosur luftonte për pavarësi nga Jugosllavia, pas anulimit të autonomisë së Kosovës nga ana e Beogradit, dhe mori përgjegjësinë për disa sulme ndaj policisë. Aksionet e tij thyen 'armëpushimin' e arritur më 1991 midis shtetit serb dhe shogërisë së vetëqajtur të pavarur dhe paralele shqiptare. Adem Jashari, i identifikuar nga shtetëtimet e sigurimit serb si udhëheqës i UÇK-së, ishte në kërkim shumë kohë para marsit. Policia ndërmori sulmin e parë të rëndë kundër shtetësisë së familjes Jashari në dhjetor 1991, por u dëbua nga rezistenca e fortë e papritur e banorëve të saj. Në një rethem të dytë të shkurtrë, më 22 janar 1998, ata plagosën vajzën e tij të mitur Iliriana dhe mbesën Selvere. Edhe kësaj radhe, Jashari i iku arrestimit. Rrethimi i fundit pasoi disa ditë pas aksionit të dhunshëm policor njëzet e katër-orësh në fshatrat e afërta të Likoshanit dhe Qirezit, në hakmarrje të hapur ndaj një aksioni të mëhershëm të UÇK-së nga fundi i shkurtit, kur guerriët lokalë u zunë pritë dhe vranë pesë policë. Bastisjet shëpi më shëpi për autorët e atij sulmi rezultuan në vdekjen e njëzet e tre shqiptarëve, përfshirë një grua shtatzënë dhe dhjetë meshkuj të një familje që nuk kishte lidhje me UÇK-në; kjo ishte vrasja e parë në shkallë të gjerë e civilëve, kurse nivelet e egërsisë i zuri të gjithë në befasi.

Më 5 mars, një forcë e madhe e forcave të përziera serbe, përfshirë policinë dhe forcat speciale të armatosura me artileri të rëndë, mbyllën vendin përreth lagjes Jashari dhe sulmuan. Sulmi përfundoi tri ditë më vonë, me një të vdekur dhe disa të plagosur në anën e policisë dhe pesëdhjetë e një të vdekur në familjen e madhe Jashari. Njëzet trupa, disa të djegur dhe të pidentifikueshëm, ishin e tëra që mbeti nga familja e ngushtë. Besarta, bija njëmbëdhjetë-vjeçar e të vëllait të Adem Jashari, Hamzës,



ishite e mbijetuarra e vetme.⁶

Përfaqësimi i Adem Jasharit si komandant legjendar filloi menjëherë pas ngjarjes, kur ai u shndërrua në një pikë bashkimi për rekrutët e UÇK-së në Kosovë dhe jashtë. Në fillim, kishë një konfuzion lidhur me lajmin. Duke kapitalizuar në këtë, pjesëtarët e UÇK-së përhapën fjalë mbi 'këjen dhe shpëtimin e mekullshëm të Adem Jasharit'.⁷ Ata krijuan imazhin e komandantit më të lartë se jeta dhe i ndihmuan mritit të jetës së pavdekshme të heroit, duke e lidhur atë me kryengritësin shqiptar në fillimin e shek. XX. Azem Galicën, i cili besoj se ishte gjallë edhe pas vdekjes së tij aktualë. Besarta ofroi dëshmitë e vërnë të këtyre ngjarjeve, të cilat shpejt u konsoliduan si rëfetim koherent heroizmi përballë një armiku shumë më të fuqishëm. Ajo rëfetime se të gjithë Jasharët morën pjesë në betejë, përdërisa 'axha Adem' këndonte këngë patriotike (Colvin 1998; Hamzaj and Hoti 2003: 915). Rëfimi mbi masakrën u shërbu si material mëuesve vendorë dhe gazetarëve, të cilët brenda natës u bënë historiane kombëtare dhe pa humbur kohë artikulluan temat e mritit - rezistencë deri në vdekje, filjimi për dashurinë ndaj atdheut dhe pavdekësi - përmos një prodhimi të pasur të rëfimeve gojore dhe letërisë së shkruar. Tashmë nga lajmet e hershme të shtypit, Jashari doli si 'ndërtues i një epoke të re' (Zeri 1998: 21), kurse ngjarjet e marsit 1998 u bënë 'pikë kthese' që ndryshonte kahjen e historisë nga shtypja drejt lirisë.

Pas luftës, rriprodhimi shoqëror i legjendës së Jasharit u bë i gjithëpranishëm dhe kjo duket në vendosjen e emrit të tij shkollave, kazemave, sheshëve dhe rrugëve anëmbanë Kosovës. Ka shumë paraqitje të Adem Jasharit si luftëtar trim nëpër këngët popullore, kartolina, kalendare, medalje, postera, plaka bakri, orë, fletore shkollore, apo suvenire të tjera. Të bëra me qëllim të inkurajimit të mritënjohjes ndaj tij, ato shiten në shitorën e suvenireve në Kompleksin Përkujtimor të Prekazit, një park që përshin të tri shtëpitë e bombarduara të familjes Jashari dhe varrezat aty afër (shih figurën 1). Për një numër të madh shqiptarësh nga rajoni dhe jashtë tij, ky vend është një altar dhe shenjtëria e tij është e përcaktuar, në kupimin durkheimian, nga fakti i thjeshtë se ky vend dhe njerëzit e tij janë veçar nga e zakonshmja, profania. Murat Jashari, nipi i Adem Jasharit, interpreton në mënyrë të ngjeshur dhe të qartë përjepsëtimin mritik të rëfimit të familjes së tij:

Çdo komb ka një shenjtëror dhe një histori që është themel që formon shoqërinë, bazën e saj. Rëfimi i familjes sime është një halikë e zinxhirit, një lëvizje historike. Historia është një zinxhir që i ka rënëjt tek lufta e shqiptarëve, Azem Galica, Shaban Pollluzha dhe të tjerët. Shqiptarët kanë qenë përherë nën shtypjen e huaj, qoftë nga

6 Organizatat për të drejtat e njeriut (KMLDNJ 1998; Amnesty International 1998;

Humanitarian Law Center 1998), si dhe mediat botërore, bahmuan mbi ngjarjet në Prekaz.

7 Policia serbe raportonte se Jasharët sulmuan policinë dhe jo e kundërta. (Federal Republic 2000: 346).

8 Intervistë me themeluesin dhe komandantin e UÇK-së, Rexhep Selimi, Prishtinë, 9 nëntor 2004.

Turqia, Austria, Serbia dhe ka pasur shumë momente të luftës për liri: kjo është gëshji; shqiptarë në Ballkan.⁸

Mirin themelor të Jasharit e mbajnë gjallë anëtarët e familjes, ish-luftëtarët e UÇK-së, të cilët kur u çmobilizuan u shndërruan në organizatën mbrojtëse civile Trupa e Mbrojtjes së Kosovës apo TMK, shogarat e veteraneve, politikanët, mëuesit rurali dhe gazetarët. Shumë nga këta sipërmarrës të kujtesës jetojnë në qytete dhe në kryeqytet Prishtinë, por janë, në masë të madhe, nga rajoni rural qendror i Drenicës, vendlindja, Jasharit dhe nga rajonet e Dukagjinit dhe të Llapit, ku shtypja shtetërore është ushtrua shumë më fuqishëm nga qeveria qëndrore jugosllave dhe ku, gjatë luftës, ka ndodhur brutaliteti më i madh. Ata angazhohen në kremtimin e kultit të Jasharit përmes ceremoniv dhe përkujtimeve, ngritjes së fondeve, duke rrefyer tregimin përmas të gjitha formav të medias dhe duke shkruar historinë nëpër libra komerciale dhe arsimorë. Në sponsorizimin e Zyres së Kryeministrit, kremtimi vjetori i masakrës së Jasharëve është bërë kremtim kombëtar, një ngjarje treditore me paradë të stilit ushtarak nga ana TMK-së; një tubim solemn me ftesa i sponsorizuar nga Zyra e Kryeministrit (që ng viti 2003); si dhe një parade gjatë tërë natës me muzikë dhe valle tradicionale përret zjarresh. Këto ngjarje mbulohen gjercësist nga të gjitha mediat e Kosovës, kurs stacioni televiziv publik sjell transmetimin të drejtpërdrejtë. Nuk ka asgjë unike në Kosovë në këtë konstruktin të legjendës kombëtare. Në mënyrë që të mbështesin kërkuesin tyre për shtetësi, shumë grupe të tjera kanë krijuar lidhje mes ngjarjeve të vona historik me një të kaluar më të largët, por dhe më të veçantë. Ashu si mriti themelues i betejës së Tel Hait dhe heroi legjendar Trumpeldor i viteve 1920 të Shogërisë Jezuite të Palestinë (Zerrbavel 1994), dhe ashtu si rrethimi dhe betejja e Alamos në vitin 1836 në Tekkas n epikën e vdekjes së Deivid Kroket (Brear 1995), rëfimi i Prekazit dhe Adem Jasharit sje një narracion shumë të fuqishëm dhe lidhje me kujtesën. Të gjitha këto masakra shtënoj një shkëputje me të tashmen dhe japin një cylie për veprimet të reja të mbështetura i një të kaluar të caktuar frymëzuese. Protagonistët u vranë, por nuk përfaqësohen si humbur: ata nuk konsiderohen viktima, por heronj që nuk pranojnë të dorëzohen. At në fakt, quhen 'dëshmorë të kombit' që nuk është e njëjtë me *shahidin* (martirin islamik të Xhinadit), ndonëse Jasharët, si dhe pjesa dërmuese e shqiptarëve në Kosovë, jar myslimanë. Ata janë dëshmorë në kupimin burimor të 'dëshmisë së kanzës', që është e pranishme në teologjitë e krishtera dhe islame: ndonëse atyre ju mohua kombësia, a dëshmojnë me martirizimin e vet se kombi ekziston.

Figura e Adem Jasharit i kishie të gjitha elementet vendimtarë për t'u shndërru në legjendë. Në kontekstin e kohës, sidomos të vitit 1998, kur më shumë se 300 civi shqiptarë u vranë nga forcat serbe në 'masakra të rëndomta',⁹ Prekazi qëndron

8 Intervistë me Murat Jasharin, Prekaz, 19 nëntor 2004.

9 Huazuan termin 'masakër e zakonshme' nga historianë që shkruajnë për vrasjen nga ana e ushtrisë gjermane të mijta civileve në Italiinë e okupuar (1934-5) dhe në kontekst të një lufte që nuk bënte dallimin mes civilëve dhe luftëtarëve. Nutri i civilëve të masakruar në Kosovë gjatë vitit 1998 mbështet në shtëtimet e KMLDNJ dhe Human Rights Watch mbi vrasjet e civilëve në Lybeniq, Polkic i Ri, Rasa e Zogut, Rahovec, Dragobil, Ranqë, Galice, Klinë and

veçuar si një rast i jashtëzakonshëm. Jasharët thjesht nuk u pushtatuan, ata u përgjigjen zjarrit me zjarr. Adem Jashari u bë simboli i parë i një lloji tjetër të shqiptarit nga ai i shlyptur, por pagësor që dominonte gjatë viteve 1990; ai shënoi një ndryshim të rëndësishëm në qëndrimet popullore, sepse shqiptarët ndoqën shembullin e tij dhe u bashkuan me mijëra si vullnetarë në kryengritjen e armatosur. Legjenda e Adem Jasharit paraqet kështu një kundër-narrativë ndaj asaj të viktimizimit dhe akomodimit me armikun. Një kadet i ri i TMMK-së përshkruante atë që ndjente gjatë vizitave të tij të shumta në Kompleksin e Prekazit si ndjenjë të krenarisë kombëtare, 'ajje ne të gjithë ndjehemi krenarë që jemi shqiptarë', është një koment që degjohet edhe nga shumë vizitorë të tjerë tek vendi i shenjtë i Jasharëve.

I lindur dhe i rritur në shoqërimë rurale të rajonit të Drenicës, Adem Jashari identifikohet lehtë nga figurat e tjera heroike vendore; ai është mishërim i përkryer i imazhit të 'patriotit të vërtetë shqiptar' në kundërshtim me 'korrumpimin e hamendësuar jugosllav' të popullsisë urbane përmes dhënies së perfitimeve politike dhe financiare nga ana e shtetit. Në një mënyrë fare moderne, ai sikur e kishte konstruktuar veten si figurë legjendare. Thuhet se stili i tij ishte ai i prijësit kryengritës kundër osmanëve, Çerçiz Topullit. Nipi i tij, Bashkimi, i cili i shpëtoi rrethimit në ditën e parë të sulmit, rikujton se në mëngjes Adem Jashari këndonte këngë patriotike, një prej tyre nga filmi i vitit 1979, *Liria Valdeje*, një biografi filmike popullore mbi Topullin (Hamzaj and Hoti 2003: 103). Dëshmi të tjera e kujtojnë atë si njeri që fliste me fjalë teatrale ku ia kerkonte rasti, si në fjalimin mbajtur para shokëve të tij pas sulmit policor në Likoshan: 'ju sot jemi plagosur që ne të jemi neshë të lirë'.¹⁰

Zhvillimi i legjendës së Adem Jasharit pas vitit 1998 shpalos fatin individual të heroi duke e vënë atë në kornizën e një leksikoni kulturor dhe politik të venut të Shqipërisë/Kosovës, që rezonon në veçanti me popullin nga viset rurale. Sugjerimet rurale tradicionaliste janë të ndërtuara me vetëdije në një narrativë thelbësore, në mënyrë që legjenda të tregohet dhe ritregohet në stilin vendor të këngëve folklorike epike. Ata këndojnë vendin, Drenicën, 'malet', dhe pajisjet tipike të heronjve luftëtarë shqiptarë: pushkën, nganjëherë giftelinë, kullën dhe odën, ku plegtë rëndom recitojnë epikën heroike të patriotëve kryengritës shqiptarë (Halimi and Shala 2000: 14). Të gjitha këto tema, të citat janë me bollëk në folklorin shqiptar, përbënin një përvojë jetësore për Jasharët. Patriarku Shaban e dinte përmendësh epikën prej 15,613 vargjeve të *Luhurës së Malcës*, që e paraqet historinë e shqiptarëve nga viti 1863 e deri më 1913 si një luftë për liri. Ne e mësuam këtë nga një i afërt, babai i të cilit, mësuës, e solli këtë tekst në Drenicë në vitet 1950. Kohë kur librat në shqip ishin ende të paligjishëm; si shumë të tjerë në atë kohë, e mësoi përmendësh këtë poemë për ta recituar në odë.

Në viset rurale anembanë Kosovës, oda ka qenë dhe vazhdon të jetë hapësira kryesore e shogëzimit të burrave dhe ku arti i të rëfyerit mbahet gjallë. Për një sipërmarrë të vjetër i lindur në Drenicë dhe që mërgoi në Nju Jork në vitet 1960, oda ishte 'shkolla e jetës'. 'Çdo gjë që kam dëgjuar në odë ende është e ngulitur në kokën time', thoshte një ish-komandant i UÇK-së nga një fshat në komunën jugore të Gjilanit

- 'Ende më kujtohet kur hyra për herë të parë në odë, isha 13-vjeç dhe ata po këndonin këngën e Fazli Graiceviçit,¹¹ dhe sot kur mendoj për këtë ende rrengethem'. Një i ri 18-vjeçar nga fshati lindor i Therandës shpjegon, 'kur nuk kishim shkolla dhe ku nuk kishim ku të shkollim, ne rrimin në odë, ku mësonim mbi vendin, popullin dhe traditën tonë, dëgjonim këngë dhe rrimin me miq'.

Rëfimet e treguara në odë, ashtu si këngët e reja të shkruar në nderim të Adem Jasharit, krenojnë gjithashtu konceptin kyç të 'mbajtjes së fjalës së dhënë', 'besnikërisë' apo 'garantimit të zotimit', *besës*, që është nxjerrë nga ligji zakonor tradicional apo *Kanuni*. Ky koncept përshkruan obligimet dhe marrëdhëniet mes familjeve dhe me mikun, kërkon një solidaritet të brendshëm, besnikëri dhe përkushtim në sjellje dhe rezervim ndaj të huajt (Schwandler-Stevens 1999). Besa është në thelb të këtij koncepti të vullnetit apo 'amanetit' të të parëve, pasi që kërkon besnikëri të pafund, në këtë rast të luftës për çlirim, pavarësi dhe bashkim kombëtar, përtej jetës individuale dhe brez pas brezi. Në vazhdim të master-narracionit, Jashari bashkoi popullin shqiptar dhe i dha atij misionin e ndërtimit të kombit. Në librat e vizitorëve në Prekaz, shumë vizitorë e pranojnë hapur amanetin e Jasharit, zotimin e tij për 'pavarësi' dhe 'liri' si një trashëgimi, realizimi i së cilës u është besuar të gjallëve. Legjenda e Jasharëve është shembull se si një ligjëritim i ri kombëtar ka përveçësuar një koncept të mbështetur tradicionalisht në organizimin vendor, patriarkal shoqëror dhe ka bërë që një detyrim familjar, patriarkal ndërbrezor të marrë përmasat e një detyrimi kombëtar.

Zëra mospajtuës

Si një ideologji kombëtare e rrejtësuar, si faktikisht ashtu edhe figurativisht, në peizazhin tradicional kosovar, legjenda e Jasharit depërton paksa me vështrësi në qytete, sidomos në kryeqytet, Prishtinë gjendet vetëm 30 milje larg Prekazit dhe si një qendër urbane është vetëm gjysmë shekulli e vjetër, por në shumë aspekte është botë tjetër nga Kosova rurale. Si qendër e qeverisë provinciale, e mediave dhe gjykatave, si dhe e universitetit më të madh, ajo përfitoi më shumë nga çdo qendër tjetër nga afërsia e saj me shtetin jugosllav dhe me strukturën e pushtetit komunist pasi Kosovës iu dha statusi i autonomisë në vitet 1970. Sipas tregimeve të ndryshme, Prishtina përshkrimet si e populluar nga një klasë e mesme që ngeli e pavetëdijësuar apo indiferente ndaj vuajtjes që pësonte viset rurale gjatë luftës. Ajo mbeti gjysmë e zbrazët nga trupat serbe gjatë ndërhyrjes së NATO-s, por shkatërrimi i pasurisë u ndal vetëm te plaçkajtjet, që ndorëse ishte në përmasa të mëdha, i lanë të paprekura dhe të banueshme strukturat fizike rezidenciale. Menjëherë pas luftës, Prishtina u rri shumë dhe u shqua edhe më shumë kundruall pjesës tjetër të krahinës. Ka një përqendrim të ri të selive ndërkombëtare dhe të pranisë diplomatike, por është krijuar edhe një elitë e re politike nga përvoja e luftës, që ka fituar pozicione të rëndësishme në Kuvend dhe qeveri; një masë e madhe e njerëzve u zhvendosën prej viseve rurale, duke lënë gërmadhat e

¹⁰ Intervistë me veteranin e UÇK-së, komandant Sabit Lladrovci, Prishtinë, 7 mars 2005.

¹¹ Militant nacionalist shqiptar, i cili vdiq në paraburgim në vitin 1968.

shpëjvive të tyre për të rindërtuar jetën në qytet. Fshati ka ardhur në kryeqytet, por ai asocioni nuk e sundon atë.

Në Prishtinë dëgjuaam shumë zëra të nëndheshëm mospajlues me kultin e Adem Jasharit. Mirëpo, ata nuk janë strukturuar si kundër-narracion për ndonjë kritikë publike ndaj komandantit legjendar, gjë që do të ishte baraz me blasfemi. Na ka tënë të dëgjojmë komente kritike në biseda private, të përcaktuara kryesisht si refuzim ndaj tradiconalizmit. Tradiconalizmi bëhet estetikisht i pakëndshëm dhe mbi bëhet burim i mospajlimit privat, gofë i shfaqur në artin monumental, që riprodhon materialisht miin e Jasharit, gofë si nënkëst i rëfimit mbi jetën dhe vdekjen e familjes Jashari.

Më 28 nëntor 2004, shtatorja e Adem Jasharit u zbulua në qendër të sheshit me të njëjtin emër në Skënderaj, qytet komunal i Prëkazit. Një estetikë moderniste e rrejësor në ikonografinë përkujtimore socialiste e karakterizon këtë monument, sikurse shumica e përfaqësimeve të tjera të Jasharit (shih fig. 2). Përfaqësimet e tilla, ndonëse të kënaqësimeve për dia, tjetërsojnë shumë banorë të qyteteve që e shohin veten si më të edukuar dhe më kozmopolitë se ‘kanundarët’. Kritika e tyre nuk nënkupton kundërshtim tëësor ndaj përkujtimit: për shembull, memoriali i ri i UÇK-së, një kopje e saktë e Memorialit të Veleranëve të Vjetnamit në Uashington, i ngritur jashtë Skënderajit ka patur një pranueshmëri të gjërë në mesin e po a tyre kritikeve. Reagimi i tyre kundër prapambetjes së estetikës socialiste vjen së pari sepse ajo duket e huaj për botën perëndimore, së cilës ata duan t’i përkasin dhe së cilës ata mendojnë se i kanë takuar gjithmonë. ‘Kuj jemi kështu, në Korenë e Veriut?’, ishte pyetja retorike e një veprimtari OJQ-je në Prishtinë, që komentonte zbulimin e shtatorës së Jasharit në Skënderaj, krenutit solemn të së cilës iu dha publicitet i madh nga të gjitha mediat.

Gratë urbane ofrojnë një kritikë të fokusuar ndryshe. Nuk është për t’u befazuar që ato do të ishin të gatshme të distancoheshin nga legjenda e Jasharëve. Miti i sakrificës heroike personale, të sanksionuar me gjak, është një tregues kulturor i patriarkalizmit, kurse legjenda e Jasharëve dëshmon cilësi të fuqishme gjinore. Këto të fundit në mënyrë specifike ritheksojnë rendin shoqëror dhe idealat maskulllore karakteristike të traditës shqiptare, një rend që anashkallon dhe marginalizon gruan në sferën publike. Një e re profesioniste në Prishtinë, duke shprehur mendimin e saj, të cilin e dëgjuaam shumë herë në biseda private, na tha: ‘Po të më pyesni mua, do t’u thosha se Adem Jashari ka genë i gmendur. Askush nuk ka të drejtë t’i çojë drejt vdekjes femijet dhe gruan e vet. Por unë nuk do t’ia shprehja mendimin askujt dhe po ta bënit këtë, unë do ta mohoja që i kam thënë këto fjalë’. Këtu shtrohet problemi i nocioneve të kundërta të moralitetit familiar, sidomos të të drejtave dhe detyrimeve të babait. Cili burrë do të sakrifikonte femijet e vet për një kauzë, sado e mirë të jetë ajo? Kjo pyetje nënkupton një gjykim negativ të primitivizmit të supozuar të Jasharëve, të përkufizuar nga një kulture patriarkale, që i jep babait pronësi të plotë mbi familjen e tij.

Ligjërimi hegjemonik i master-narracionit të pasluftës e ben edhe më të vështirë për gratë që të sfidojnë nënshtrimin e tyre në rendin patriarkal të përcaktuar për to dhe femijet e tyre në familjen e burrit, e lëre më që të kërkojnë prijësi në shoqërimin e interpretuar si të ndërtuar nga burrat. Mbi këtë qëshije nuk ka debat publik. Drama *Mar-less* nga Jeta Xharra grek pikërisht dramën e atyre grave të cilave aspektet minke

të luftës ua mohojnë një vend në Kosovën e pasluftës. Ajo u vu në skenë në Londër në anglisht më 2004, sepse autorja mendoon se tani nuk është koha që të vihet në skenë në shqip në Kosovë.¹² Gratë nuk kanë vend me peshtë në përkujtimoret zyrtare dhe private që u kushohen dëshmorëve të luftës. Mëgjithkëtë, një numër i vogël i tyre iu bashkëru UÇK-së. Ato pa dyshim kanë luajtur një rol mbështetës në rezistencën e armatosur. Gratë shërbenin si korriere, ndihmëse, kuzhinere dhe infermiere, detyra këto që nuk gëzojnë krenim pas përfundimit të luftës. Si në shumicën e shoqërive, ato u dhunuan dhe u vranë si viktima të luftës prej armikut, por pastaj u harruan. Dhunimet në masë të madhe dhe sistematike që ndodhën gjatë luftës kishin vëmendjen e opinionit publik vetëm gjatë kohës së konfliktit, kurse në Kosovën e pasluftës qëshija e dhunimeve s krim lufte është thelur fare nga ligjërimi politik, duke i lënë viktimat që të ballafaqohet me tragjedinë e tyre në mënyrë private.

Së fundi, roli i grave në rezistencën paqësore dhe civile ndaj regjimit të Beogradi të zhvilluar gjatë viteve 1990, është anashkalluar tërësisht. Shumë prej tyre e pësuan në kontekstin e përgjithshëm të humbjes së vendeve të punës, por shumë u angazhuar nëpër shkolla dhe spitale të shoqërisë vetëndimnuese, në atë çfarë ishte shëndërrta shogëria kosovare. Veprimtaret politike vuajtën nga burgosjet dhe torturat. Sol, s atëherë, njohta e rolit të gruas në shoqëri është përgjithësisht i heshur dhe i nënshtrua ndaj ‘qeshjes kombëtare’. Kritika e ligjërimit me mbështetje tradiconaliste rurale pasqyroon një debat që nxjerr në pah dallimin e vjetër mes fsharit dhe qytetit, s prapambetje kundrrall qytetërimin. Shumë banorë shqiptarë të qyteteve, në një mënyrë tipike sipas ‘orientalizmit të brendshëm’ (ang. ‘nesting orientalism’), i kanë përgjyrua gjithmonë katundarët ‘e prapambetur’, duke i bartur tek ata përgjithësimet stereotipike të ‘prapambetjes’ që u përshturbei të gjithë shqiptarëve nga mendësia dominuese në ish-Jugosllavi (Bakic-Hayden 1995).*

Kjo dukuri është parë të shfaqet në politike përmes daljes së udhëheqësve të rinj, që kanë pak apo aspak lidhje me elitat urbane të pasluftës, të cilat ende janë të spikatura në Kosovë. Ndonëse pohuaise të gjithë politikantë e pasluftës kanë diplomë universiteti, në disa raste të marra jashtë vendit, ata vazhdojnë të jenë objekt i kritikave nga më të rrepat për mungesë solistikimi. ‘Ata janë fshatarë. Fshatarët gjithmonë kanë genë luftëtarë të mirë, por ata nuk duhet të marrin pushtetin politik’, ishte një koment gjatë një bisede në një familje në Gjilan, që e dëgjuaam shumë herë gjatë me ndryshime të pakta.

12 Intervistë me Jeta Xharren, 11 mars 2005.

* Termi origjinal në anglisht ‘nesting orientalism’ i referohet konceptit klasik të ‘Orientalizmit’ në librin me të njëjtin titull i studiuesit Edward Said ‘Orientalism’ (1979). Ky koncept shqyroon mënyrat me të cilat fuqitë koloniale perëndimore shikonin subjektet e tyre të kolonizuara të Lindjes. Studjuesja Milena Bakic shqyroon riprodhimin e kënjë diskutonitë madris lindjes dhe perëndimit brenda kontekstit ballkanik. Ku ‘lindja’ përfaqësohet nga ‘qyteti’ i esencialisuar që qëndron përkundrej një ‘perëndimiti të civilizuar’, ky riprodhim vendos një hierarki të kornthëve sipas nivelit të tyre të supozuar të zhvillimit. Psh. slllovanët shkojnë sërbët si ‘lindje’, kurse sërbët shkojnë shqiptarët si të tilla. Në rastin tone diskutonja ‘Perëndimi’-‘Lindje’, si binom ‘zhvillim’-‘prapambetje’, përfaqësohet nga diferencat midis qytetarëve dhe fshatarëve, këta të fundit të marrë si të ‘pazhvilluar’, (shën. i red.).

Ndonese përgendrimi ynë në qytete, sidomos në Prishtinë, është i dobishëm dhe i duhur për interpretimin e kundërvënëve kulturore ndaj master-narracionit, një çështje ndërthdëse, që nuk është ekskluzivisht urbane në karakter, duhet po ashtu të merret parasysh: parapëlqimi ndaj mjeteve jo të dhunshme për arritjen e synimit të pavarësisë. Pas luftës, mbi themelat e heroit luftëtar ka zëvendësuar mitin e kundërshtimit paqësor ndaj regjimit të Beogradit gjatë viteve 1990 – në trajtën e shoqërisë paralele të Presidentit Ibrahim Rugova, udhëheqës i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK).¹³ - të quajtur në një kohë si 'gandistë'. Shumë prej atyre që në atë kohë zgjidhën rrugën paqësore nuk pajtohen me rezistencën e armatosur. Ata i takojnë një spektri të gjerë shoqëror dhe gjeografik - 'zonës së përhimtë' amorfe, sipas një nocióni të Primo Levi - të konformistëve, të atyre që u përshatën me aparceidin e shoqërisë paralele.¹⁴

Në vitet 1990, shtypja ishte e madhe ndaj shqiptarëve, por shumë prej tyre i ishin përshatur asaj. Zgjedhja e rezistencës civile e kishte bërë të panevojshëm shumën e dhunës nga ana e Millosheviçit. I detyruar të shtypte rebelimin e UÇK-së -thone këta zëra- regjimi u detyrua të bëhej më brutal. Përfundimi që rrjedh është se UÇK-ja i dha ndihmesë procesit të spirales së luftës dhe dhunës. Disa njerëz na thanë se gjatë luftës ata i kishin hedhur armët ngaqë nuk donin të provokonin policinë dhe të vinin në trezik familjet e tyre. Një grua e ve na tha se ajo do të kishte më shumë dëshirë të shinte t'i kthehej i shogi sesa një 'Kosovë të lire'. Gjatë bisedave me banorët e Rahovecit dëgjuaam argumentin se sikur të mos ishte përjექja donkishoteske e UÇK-së për të pushtuar qytetin në korrik 1998, trupat serbe nuk do të hakmerreshin me masakrën që pasoi kundër civilëve. Të tërë këta zëra vazhdojnë të mbeten privatë, pasi që të mbash përjექjese UÇK-në, fëmijarët, për vdekjen e të pafajshmeve nuk është një argument që mund të bëhet publik.

Në propozojmë se një hipotezë për dominimin publik të master-narrativës së Prekazit është mbështetja e tij në një traumë kolektive, e aftë për të prodhuar identifikim të fuqishëm kolektiv në mesin e komuniteteve shqiptare. Ndonëse roli patriarkal në vdekjen e Jasharit do të mund të ishte objekt denoncimesh, rëfimi i masakrës së Jasharëve sjell një simbolizëm të fortë dhe të ngjeshur mbi një vuajtjeje të madhe, që prek shumëkënd dhe që i bashkon ata në një bashkësi kombëtare. Kur kërkuaam shpjegim për mosgatishmëritë e tyre për të kritikuar publikisht Adem Jasharin, shumë nga të ankuarët na thanë se sakrificat e tij e jashtëzakonshme, që është e pamundur të shpëgurohet në atë masë, i shtërngon ata të jenë mirënjohës. Ndonëse ata refuzojnë rikonfigurimin e master-narracionit të rezistencës civile të Rugovës si kolaboracionizëm të një partie të bindur, nga ana tjetër ata pohojnë se pa Jasharin dhe vullnetin për të luftuar, Kosova ende do të ishte shoqëri e aparteidit. Mijëra familje shqiptare kanë përjექuar vdekje të dhunshme, burgosje dhe/apo humbje të pasurisë private nga politika shëterore serbe. Rrëfimi i Jasharëve, siç është konstruktuar, është narracion në progresion, që ka krijuar një lidhje të fuqishme midis këtij pësimi dhe shpëtimit prej tij.

13 Dr Ibrahim Rugova, Kryetar i Shoqatës së Shkrimtarëve, ishte njëri nga themeluesit e LDK-së në vitin 1989. Me 1992 ai u zgjodh President i Republikës së vetëshpallur të Kosovës.

14 Levi shkruan lidhur me 'shtetën e ambiguitetit dhe kompromisit' që përthën pjesën më të madhe të shoqërisë shtetërore nën një autoritet mbizotërues romasiv (Levi 1989: 67, 3669).

Kujtesa vendore dhe ndërkombëtare

Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) është mandatar në radhë të parë për të krijuar një qeveri të përkohshme dhe për të ndërtuar një shoqëri multietnike deri në përcaktimin e një statusi final për Kosovën. Paradoksi është se me arritjen e institucioneve të përkohshme të vetëqeverisjes, Kosova e pasluftës është bërë një konstrukt i përgudshëm. Ajo është një territor me një President, Kuvend, me ministri dhe me një organizatë civile të mbrojtjes. Trupat Mbrotjtëse të Kosovës, me synim për t'u bërë ushtri. Prapëseprapë asaj i mungon çfarëdo atributi i sovranitetit dhe mbetet nën tutelën e një protektorati ndërkombëtar. Në gjuhën diplomatike, kjo shpesh quhet 'ambiguitet kreativ' (ang. 'creative ambiguity'); jashtë këtij eufemizmi, një raport i pavarur i kohëve të fundit i OKB-së, e quan këtë si 'mungesë të orientimit dhe të një plani gjithëpërfshirës, që do të ofronë bashkësia ndërkombëtare' dhe arsyetja se pse UNMIK-u është përdorur kryesisht për të 'mbajtur kapakun mbyllur' (Eide 2004: paragrafi 11). Derisa të zgjidhet kjo gjendje dhe derisa serbët vendore të refuzojnë të marrin pjesë në qeverisje dhe vazhdojnë të varen nga Beogradi për roga dhe shërbime, shqiptarët konstituohen si subjektë të vetëm të UNMIK-ut. Një shembull ilustron këtë gjendje: si bartës të dokumenteve të udhëtimit të UNMIK-ut, që kanë zëvendësuar pasportat jugosllave, shqiptarët në Kosovë janë Klasifikuar si grup unik, të identifikuar vetëm në bazë të emicitetit të tyre (Blumi 2003). Nën protektoratin ndërkombëtar, shqiptarët në Kosovë përjetojnë pavarësinë e tyre aq të dëshnuar vetëm si 'hiri nga serbët', një përvojë që përforcon identitetin dhe solidaritetin e tyre etnik.

Një shembull, i ndodhur në Prekaz, është shumë domethënës. Në tetor të vitit 2003, trupat franceze të NATO-s hynë në një konfrontim të armatosur me Murat Jasharin dhe të mbijetuarit e tjerë, pasi kishin bastisur pronën e tyre për armë për dy ditë me radhë. Ata nuk kishin leje, që për trupat e NATO-s në Kosovë nuk kërkohet me ligj, por që u kërkua nga Jasharët si kusht për zbatim. Emocionet ishin të larta jo vetëm në Prekaz por ngado, pasi që ky incident këu kujtimet e dhimbshme të luftës. Sipas një thashethemaje të ashpër që u përhap në mesin e shqiptarëve, por që doji se ishte plotësisht e pabazë, ushtarët francezë i ishin sulur pronës së Jasharëve të delhur dhe duke kënduar, një karakterizim ky që në mënyrë të hapur i bashkëshoqëron ata me sjelljen e trupave serbe gjatë luftës. Duke parë raportet televizive të kësaj ngjarjeje dhe duke folur me të dy protagonistët e atij incidenti dhe me ata që vetëm sa e bisedonin këtë nëpër kafenetë e kryeqytetit, zbuluam se kishte një solidaritet të jashtëzakonshëm me Jasharët. Ky bashkëpëlqim është pasqyrim i atij që ekziston në udhëheqjen politike me Kupuan se kritika ekzistuese ndaj legjendës së Jasharëve treqet menjëherë sapu sulmohet kjo familje, e cila është simbol i pavarësisë shqiptare nga ndërrytja e huaj.

Me atë rast, Murat Jashari ndihet posaçërisht i fryer nga mungesa e respekti ndaj vendit të shenjtë të familjes nga ushtarët francezë; ata kishin shkelur mbi vendit e masakrës, duke dhunuar kështu 'vendin e shenjtë'.¹⁵ Ai po ashtu ishte fryer ng pandehma se familja e tij do të mund të ishte e përfshirë në veprimtari të paligjshme Indiferenca dhe mosnjohja me paramendim kanë karakterizuar në masë të madh

15 Intervista me Murat Jasharin, Prekaz, 28 tetor 2003.

qëndrimin e aktorëve ndërkombëtarë ndaj legendës së Jasharëve dhe rolin ikonik të saj në mesin e shqiptarëve. Ky qëndrim është konsistent me refuzimin për t' u angazhuar me kuptimin që kanë vendasi për shtetësinë dhe kjo thellohet hendekun midis dy shoqërive dhe realiteteve, atij ndërkombëtar dhe atij vendor.


Etnografia jonë propozon se administratorët nuk e shohin shoqërinë kosovare si një subjekt politik të formësuar nga një histori specifike, në të cilën ndërveprimi dhe harmonia me pushtetin shtetëror, përfshirë edhe administratën ndërkombëtare, luajnë rol vendimtar. Ata e kuptojnë atë kryesisht përmes thjerrëzash të kategorizimeve të tilla të depolizuara si viktimë dhe kriminel. Gjatë kohës së 'ndërrhyjes humanitare' – atëherë një nocion në qendër të një debati të thukët – aktorët ndërkombëtarë i supozojnë shqiptarët viktimë të paafajshme, duke flakur përkohësisht gjykimin e tyre ndaj guerriës UÇK. Në nivelin simbolik, ky kuptim mbështetëj në bartjen e imazhit të holokaustit, së pari në Bosnjë e pastaj në Kosovë. Ka dëshmi të bollshme se kujtimet e Luftës së Dytë Botërore kishin një ndikim tek disa, sidomos në vendimin e trupit diplomatik të SHBA-ve (Albright 2003: 382; Clark 2001: 11); dhe holokausti u përmend më vonë për të arsyeuar ndërhyrjen ushtarake të NATO-s, që kuptohej si veprim 'shpëtimtar' për dëshmitar në përgjithësi të NATO-s, jo vetëm gjatë Luftës së Dytë Botërore, por edhe gjatë Luftës së Bosnjës (Levy and Sznajder 2002: 99). Kur menjëherë pas konfliktit, shumica e serbëve e lëshuan Kosovën, apo u detyruan të iknin nga një klimë dhune dhe frikësimi, termi 'spastrimi etnik i anasjelltë' (ang. reversed ethnic cleansing) zuri të përdorej me të madhe për të përshkruar përgjegjësinë kolektive të shqiptarëve.¹⁶ Pas luftës, serbët u bënë viktimë.

Vëzhgimet e shtrira dhe intervistat [nga 1999 - 2005] konfirmojnë se shumica e 'ndërkombëtarëve', siç quhen rëndom ushtaraktë dhe civilët e huaj, kanë pak apo aspak kujtesë ndaj ngjarjeve të marsit të vitit 1998, edhe aq më pak duan ta vizitojnë Prekazin. Edhe nëse dinë për Prekazin, ata faktikisht dhe figurativisht qëndrojnë larg nga ky vend. Një zyrtar i lartë ndërkombëtar na shoqëroi njëherë tek Memoriali, por refuzoi të dilte nga makina nga frika se mos shihej në këtë vend. 'Ata nuk duan që të shfaqen sikur mbajnë anën e dikujt', shpjegoi kështu diplomati perëndimor qëndrimin e shumicës së kolegeve të tij. Me përjashtim të Kryeadministratit të parë të OKB-së, Bernard Kushner, vizitat zyrtare të profilit të lartë deri vonë kanë patur cilësi aksidentale.

Krahasojeni këtë me rolin qëndror që kaulli i Adem Jasharit luan në teatrin vendor të politikës së pushtetit! Përkundër rivaliteteve politike¹⁷ dhe mospajtimeve private, simboli më i shenjtë i martirizimit kombëtar dhe afirmimit të krenarisë mbetet referim i denyrues për të gjithë politikanët e të gjitha ngjyrave, përparësia e përbashkët e të cilëve është akoma pavarësia e Kosovës. Nga fillimi i fushatës elektorale të vitit 2004,

16 Shtih deklaraten e Kofi Ananit (14 tetor 1999) në www.un.org/peace/Kosovo/news/99/pe99_2.htm dhe deklaraten për shtyp në Zëdhënësit të KFOR-it të datës 1 nëntor 1999 në www.nato.int/kosovo/press/1999/k991101a.htm

17 Ka pasur një luftë të madhe publike, me akuzë të ndersjella të tradhtisë, veprimtarisë kriminale dhe vrasjeve, që ndodhi në shtyp (Di Lellio 2005) dhe në gjykatat midis fraksioneve kundërshtarë të rezistencës së armatosur.



publicistit Yeton Surroi dhe partia e re Ora bëri një vizitë shumë të publikuar tek Memoriali i Prekazit. Presidenti Ibrahim Rugova,* i cili para vitit 1998 pohonte me këmbëngulje se UÇK-së ishte shpikje e shërbimeve sekrete serbe dhe vazhdimisht refuzonte të bashkëshpërohej në çfarëdo mënyre me UÇK-në,¹⁸ ka një raport jo të lehtë me Jasharët. Rugova nuk e ka vizituar asnjëherë Prekazin. Mbështetësit e tij thonë se asyryja është sepo ai nuk është fiuar kurrë dhe ka frikë nga ndonjë reagim negativ apo madje edhe të dhunshëm, derisa kritikuesit e tij pohojnë se atij nuk i intereson ai vend. Megjithatë, madje edhe ai kërkoi bashkëshpërim me Jasharët. Në disa raste, *Boia sot*, gazetë e afërt me partinë e tij, ka botuar një fotografi që paraqet Rugovën në një takim në Tiranë, në fillim të viteve 1990, me Adem Jasharin që qëndron në këmbë pas tij.¹⁹ Kjo bëhej për të dëshmuar marrëdhëniet politike midis dy liderëve, kur në fakt as që ka ekzistuar, si dhe për të denoncuar liderin rival politik dhe përfaqësuesin e UÇK-së, Hashim Thaçin,²⁰ se ai gjoja përdor një 'fotografi të fallsisfikuar' të tij me Jasharin. Kjo fotografi tregon Jasharin me dorën e tij në shpatullat e Thaçit dhe është riprodhuar nëpër kalendare dhe në një poster të *Epokës së re*, gazetë e afërt me partinë e Thaçit, me poshtëshkrimin: 'Legjendat kanë ardhmëri'. Së voni, kemi hetuar një ngjarje të një kundër-narrative që vë Adem Jasharin plotësisht në kampin e Rugovës. Jashari ka qenë turrprijë e Rugovës... Presidenti e ka dërguar atë në Shqipëri për t'u stërvitur si luftëtar', thoshte një student i ri, në një debat me një simpantuzes të UÇK-së. Një ihtar i LDK-së sugjeronte se UÇK-ja e ka rrembyer kujtimin mbi Adem Jasharin, i cili në jetë ka qenë 'pragmatik dhe, pa dyshim, në anën e Rugovës'.

Një pjesë e madhe e këtij debati konsiderohet si folklor vendor nga administratorët ndërkombëtarë. Për ta përmirësimit i situatës së krijuar pas lufës, me ijtjen e mijëra serbëve nga Kosova, u bë prioritet që kërkonte një 'risistemim' të Kosovës në një të tashme ahistorike të tolerancës multietnike. Ka pak, apo aspak, durim për vlerësimin politik dhe kulturor të perspektivave të ndryshme të shqiptarëve lidhur me të kaluarën e afërt të Kosovës. Të mënjantuan, këta të fundit, gjëjnë një unitet të vaktë, por të rëndësishëm në kujtimin- dhe përkujtimin-e-Prekazit. Prekazi fton secilin që t'i rezistojë thirrjes për harresë (amnezia) kolektive, - kujtim selektiv - të historisë vendore, të bërtë në mënyrë të tërthortë nga aktorët ndërkombëtarë.

Veprimtaria e krijimit të mitit kombëtar e sipërmarrësve përkujtes shqiptarë në Kosovë i ka nxjerrë dorëshkrimet kulturore nga një traditë patriarkale. Ato mbështeten në nocionin e rezistencës deri në vdekje dhe detyrimin e të gjithë brezave për të mos haruar dhe për të përfunduar punën e dëshmorëve. Ndryshe nga receta hebreje për të mos haruar, *zaklort*, bartja e së kaluarës në gjeneratat e tashme dhe të ardhshme drejtohet nga ligji zakonor dhe jo nga tekste religjioze, por ka forcë të ngjashme (Yerushalmi 1982). Ajo mbështetet në praktikat tradicionale të rëfimit të regjimeve, në të cilat përzihet historia, legjenda dhe kujtimet vejjake. Këtu, treguesi i rëfimit dhe

* Shih passhënimin

18 Intervistë me zëdhënësin e Rugovës deri në vitin 1998, 15 shtator 2005.

19 Fajza e parë (*Boia Sot* 2004).

20 Hashim Thaçi nga Drenia, ishte lider studentor, i cili emigroi në Zvicër, pjesëtar i hershëm i UÇK-së dhe themelues i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK).

historiani janë i njëjti person. Aja kanë thurur këtë vijë rëfimi për një Kosovë të pavarur: një komb i çliruar nga sundimi serb pas një rezistence të gjatë dhe të përgjashme, të ringjallur përmes sakrificës heroike të komandantit legjendar Adem Jashari.

Ky është master-narracioni që shkaktonte kundërshti dhe mospajime, por që tashmë shërben si një ikone e unitetit rreth të cilit mobilidhen shqiptarët për dy arsye të rëndësishme dhe të ndërlikura. Së pari, kujtimi për të vdekurit dhe për vuajtjen kolektive përbën një të kaluar të përbashkët për shqiptarët në Kosovë, që nuk mund të anashkalohej lehtë. Së dyti, axhenda ndërkombëtare, duke u orvatur që të imponojë vlerat e veta universaliste dhe abstrakte dhe të krijojë një shoqëri multietnike, duket si një pengesë kundruall projektit vendor për ndërtimin e shtetit. Përdërisa retorika që përdor UNMIK vazhdon t'i klasifikojë vendorë përmes kategorive të 'viktimave' apo 'kryesëve të krimit', viktima 'meritorë' dhe 'jomeritorë', vija e rëfimit shqiptar, e përgendruar në rezistencën heroike, riafirmton veprimin shqiptar dhe angazhimin e tij për të fituar pavarësinë.

Mund të ketë mospajtim të fshetur midis botërave urbane dhe rurale në Kosovë dhe në vija të tjera të ndarjes, si ato gjinore dhe politike, si në çdo shoqëri jetele komplekse, por master-narrativa vepron në dy funksione. Në retrospektivë, ajo ka zhvendosur fokusimin nga përvojat 'e turpshme' të vikimizimit/poshtërimit në zhvendosur fokusimin nga përvojat 'e turpshme' të vikimizimit/poshtërimit në transmetimin e krenarisë. Në perspektivë, ajo ka ofruar një ikonë të solidaritetit kombëtar politik dhe e ka bërë të panegociueshme kërkuesin për pavarësi. Aja që kanë rënë në një Kosovë të lirë, tani janë vënë në pozitë të motivojnë dhe mobilizojnë rezistencën ardhshme, nëse kjo është e domosdoshme.

Passhënim

Pas dorëzimit për botim të këtij artikulli në revistën "Nations and Nationalism Presidenti Ibrahim Rugova vdiq më 21 janar 2006. Vdekja e tij e mbuluar në tërë botë nga mediat, tërhoqi një përfaqësim të rëndësishëm të diplomacisë ndërkombëtare n nga mediat, duke i mundësuar kështu një ceremoni 'shetërore' për simbolin vendor pr vartim, duke i mundësuar kështu një ceremoni 'shetërore' për simbolin vendor pr babai të pavarësisë së Kosovës. Binte në sy mungesa e familjes Jashari, të gardës s TMK-së të drejtuar nga miku dhe fqinji i Jasharëve, Nuredin Lushaku, dhe i dis veteranëve të UÇK-së, të zemëruar nga vendimi për ta varrosur presidentin prar dëshmorëve të UÇK-së në Prishtinë. Me këtë vendim, LDK-ja futi Rugovën në kuadri të master-narracionit të Jasharëve, që kërcënon me 'rëmbimin' e pozitës ikonike të Adem Jasharit dhe duke zgjeruar kështu përcaktjen në mesin e ish-luftëtarëve të UÇK së nga rajone të ndryshme të Kosovës. Vdekja e Rugovës forcoi autoritetin e moral jollufarak, aktualisht të heshtur, me mundësi që të fitojë në fuqi dhe koherencë për n kundër-narracion publik.

Anna Di Iellio, PhD në sociologji në Columbia University, Nju Jork, ka dhënë leksione në sociologji në Sarah Lawrence College, Nju Jork dhe ka qenë korrespondent për Amerikën Veriore për gazeta të ndryshme italiane qysh nga viti 1991. Në 1999 a

fillon të punojë për Kombe të Bashkuara në agjensitë e emergjencave për Kosovën dhe Timorin Lindor. Në 2001, pasi mbaroi Masterin në Politikë Publike nga New York University, ajo u bë Komisionere e Medias për Kosovën. Në 2003 ajo ishte analiste kërkimesh për Organizatën Ndërkombëtare të Migracionit (IOM) mbi programin e reintegrimit të UÇK dhe Këshillatë Politike e Koordinatorit të Trepave Mbrojtëse të Kombeve të Bashkuara. Si fundi, ajo ka qënë Këshillatë Politike e Kryeministrit të Kosovës. Tani ajo jep mësim në Kosovo Institute of Journalism and Communication and at the New School for Social Research in New York. Ajo ka bërë edhe një dokumentar mbi trafikimin e grave në Kosovë për Televizionin Publik Italian RAI, si edhe ka shkruar ese mbi politikën në Kosovë. The Case of Kosovo, një përmbledhje esesh që ajo ka redaktuar është botuar këtë vit nga Anthem Press, Londer.

Stephanie Schwandner-Sievers, Balkanologe dhe Antropologe sociale (Berlin, Free University), aktualisht punon si Visiting Professor për shkollën ndërkombëtare Masters Programeve Master në Studimet e Evropës Lindore (MIREES) në Universitetin e Bolonjës, Itali. Ajo është gjithashtu edhe bashkëpunëtoëre nderi (Honorary Affiliate) në Qendrën për Studimet e Evropës Juglindore e Shkollës së Studimeve Sllavonike dhe Studimeve të Evropës Lindore (SSEES), ku qysh nga viti 1997 deri në 2003 ka punuar si studjuesja e parë e programit Alex Nash Fellow për Studimet Shqiptare. Ajo ka kryer studime etnografike në terren në Shqipëri, Kosovë dhe në diasporën shqiptare qysh nga viti 1992; ka botuar shumë artikuj mbi politikat shqiptare të përfaqësimit dhe identitetit, konstruktimit e traditës, gjinisë, sigurisë, mitit, kujtesës, migracionit dhe transnacionalizimit; ka shkruar raporte të ndryshme konsulence për prodhime që lidhen me gjykatat dhe agjensitë ndërkombëtare. Mëdis të tjerash ajo është edhe bashkëredaktore, së bashku me Bernd J. Fischer, e librit *Albanian Identities: Myth and History*, Londer: Hurst 2002.

Referencat

- Albright, Madeleine. (me Bill Woodward). 2003. *Madam Secretary: a Memoir*. New York: Mharmax Books.
- Amnesty International. 1998. *A human rights crisis in Kosovo province. Drenica, February/April 1998. Unlawful killings, extrajudicial executions and armed opposition abuses*. 30 qershor (AI INDEX: EUR 70/033/1998).
- Bakic-Hayden, Milica. 1995. 'Nesting orientalism: the case of Former Yugoslavia', *Slavic Review* 54(4): 917-31.
- Blumi, Isa. 2003. 'Ethnic borders to a democratic society in Kosovo: the UN's identity card' in Florian Bieber and 'idas Daskalovski (eds.), *Understanding the War in Kosovo*. London and Portland, OR: Frank Cass, 217-37. Bota Sol. 2004. 'Fotografia originale dhe falsifikatorët e historisë'. *Bota Sol*, 10 mars. Brear, Holly Beachley. 1995. *Inherit the Alamo: Myth and Ritual at an American Shrine*. Austin, TX: University of

- Texas Press.
- Brubaker, Rogers. 1996. *Nationalism Reframed: Nationhood and the National Question in the New Europe*. Cambridge and New York: Cambridge University Press.
- Clark, Wesley. 2001. *Waging Modern War*. New York: Public Affairs.
- Colvin, Marie. 1998. 'Kosovo's silent houses of the dead', *The Sunday Times*, 15 mars.
- Di Lellio, Anna. 2005. 'Empire lite as a swamp', *Transitions XLV*(1): 63-80.
- Di Lellio, Anna and Stephanie Schwandner-Sievers. 2006. 'Sacred Journey to a Nation: the Construction of a Shrine in Postwar Kosovo', *Journeys: The International Journal of Travel and Travel Writing* 7(1).
- Eide, Kai. 2004. *The Situation in Kosovo. Report to the Secretary General of the United Nations*. 15 korrik. (http://www.kosovo.com/news/archiv/2004/August_17_1.htm), accessed on 18 tetor 2005.
- Federal Republic of Yugoslavia. Federal Ministry of Foreign Affairs. 2000 *Terrorist acts of Albanian terrorist groups in Kosovo and Metohija. Documents and evidence*. 1 janar 1998 – 10 qershor 1999, III Part One Belgrade: Shurbeti Glasnik, Halimi Emin. and Ajmishabe. Shala. 2000. *The Jasharis: The Story of a Resistance*. Pristina Rilindja, Hamzaj, Bardh and Faik. Hoi. 2003. *Jashari: histori e rrëfyer nga Rifat Besaria, Bashkim, Murat dhe Luizim Jashari*. Prishtinë: Zëri.
- Humanitarian Law Centre. 1998. *Spotlight on: Kosovo, human rights in time of armed conflict*, Report No. 26 (maj). Belgrade: Humanitarian Law Centre.
- Jelin, Elizabeth. 2003. *State Repression and the Struggle for Memories*. London Social Science Research Council.
- KMLDNI. 1998. *Buletini*. viii/6 (January/March) Pristina: KMLDNI.
- Levi, Primo. 1989. *The Drowned and the Saved*. New York: Vintage.
- Levy, Daniel and Nathan Sznajder. 2002. 'The Holocaust and the formation of cosmopolitan memory', *European Journal of Social Theory* 5(1): 87-106.
- Rugova, Ibrahim. 1994. *La Question du Kosovo*. Paris: Fayard.
- Schwandner-Sievers, Stephanie. 1999. 'Humiliation and reconciliation in Northern Albania: the logics of feuding in symbolic and diachronic perspectives' in Georg Elver Stephan Feuchtwang and Dieter Neubert (eds.), *Dynamics of Violence: Processes of Escalation and De-escalation in Violent Group Conflicts* (Sociologus, supplement 1), 133-52. Berlin: Duncker & Humblot.
- Yenshahni, Yosef Hayin. 1982. *Zakhor: Jewish History and Jewish Memory*. Seattle, WA, and London: University of Washington Press.
- Zëri. 1998. 'Adem Jashari: Njeriu që ndërroi spoken' (Editorial section on th year's events), 26 dhjetor.
- Zerubavel, Yael. 1994. 'The historic, the legendary, and the incredible: invente tradition and collective memory in Israel' in John Gillis (ed.), *Commemorations: th Politics of National Identity*. Princeton, NJ: Princeton University Press, 105-23.